

Eja, Më Ndiq – Veprimtaritë

Për mbrëmjen e shtëpisë ose studimin
e shkrimeve të shenjta – ose thjesht për argëtim!

PËR KAPITUJT TE MOSIA 4-6

Ec në Gjurmët e Tij

Mbreti Mosia i zbatoi urdhërimet dhe “eci në udhët e Zotit” (Mosia 6:6). Në një copë letër, vizato gjurmën e këmbës sate dhe prite formën. Shkruaj në gjurmën e këmbës një mënyrë se si mund ta ndjekësh Jezusin. Vendose gjurmën e këmbës atje ku mund të kujtohesh që të ndjekësh shembullin e Jezu Krishtit.

Për fëmijët më të vegjël:

Shkoni për një ecje. Bëni që fëmija juaj të ushtrohet të ecë atje ku ecni ju. Flisni rreth mënyrës se si mund ta ndjekim Jezu Krishtin duke bërë gjërat që bëri Ai, si ndihma për të tjerët dhe pagëzimi.



PËR KAPITUJT TE MOSIA 7-10

Ndiqe Profetin

Amoni dha mësim se profetët mund të shohin gjëra që do të ndodhin (shih te Mosia 8:16–17). Shko te faja 2 për të lexuar mesazhin nga Presidenti Nelson nga konferenca e përgjithshme. Çfarë na mësoi ai? Vizato një figurë për atë mësim dhe na e dërgo te revista *Miku*.

Për fëmijët më të vegjël:

Këndoni “Ndiqe Profetin” (*Libri i Këngëve të Fëmijëve, f. 58–59*) me fëmijët tuaj. Sa herë që këndonin fjalën *profet*, tregoni me gisht nga figura e profetit.

ILLUSTRIMET NGA KATY DOCKRILL



PËR KAPITUJT TE MOSIA 11-17

Një Dritë në Errësi

Abinadi dha mësim se Jezu Krishti është “një dritë që është pa mbarim që nuk mund të errësohet kurrë” (Mosia 16:9). Fshiheni një send në shtëpi. Fikini dritat dhe bëni që çdo njeri të përpiqet ta gjejë atë në errësi. Pastaj fshiheni sendin dhe përpiquni ta gjeni atë me drita ose elektrikë dore. Cila mënyrë ishte më e lehta? Si na ndihmon Jezusi ashtu siç të ndihmoi drita?

Për fëmijët më të vegjël: Bëni që fëmija juaj të ushtrojë ndezjen dhe fikjen e një elektriku dore ose të një llambe. Pastaj bisedoni rreth mënyrës se si Jezu Krishti është një dritë që nuk mund të fshihet apo fiket kurrë.



PËR KAPITUJT TE MOSIA 18-24

Zemra të Bashkuara në Unitet

Alma na mësoi t’i kemi zemrat tona “të thurura në bashkim dhe në dashuri kundrejt njëri-tjetrit” (Mosia 18:21). Kjo do të thotë që ne duhet të punojmë së bashku dhe të tregojmë dashuri ndaj të tjerëve. Bëj një varg me zemra që të jetë si kujtues për ty! Prit disa zemra prej letre dhe shkruaj emrin e një pjesëtari të familjes në secilën prej tyre. Bëj një vrimë në secilën zemër dhe kaloje një fije spangoje mes tyre në mënyrë që zemrat të lidhen. Vare vargun e zemrave atje ku do ta shohësh shpesh!

Për fëmijët më të vegjël: Pyeteni fëmijën tuaj për një gjë që e pëlqejnë te çdo pjesëtar i familjes. Tregojini fëmijës suaj diçka që bën ai ose ajo e cila tregon dashuri ndaj të tjerëve!

